



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I MINISTRAVE
KËSHILLI KOMBËTAR I TERRITORIT

MARRËVESHJE

PËR DELEGIMIN E KOMPETENCAVE

Sot, më datë 03.12.2020, Palët e mëposhtme:

Këshilli Kombëtar i Territorit, përfaqësuar nga Kryeministri dhe Kryetari i KKT
Z. Edi Rama

dhe

Bashkia Tiranë, përfaqësuar nga Kryetari i Bashkisë Z. Erion Veliaj

Në mbështetje të neneve 28 dhe 29, të Kodit të Procedurave Administrative; neneve 7, shkronja “ç”, 14/1, pika 2, 27 dhe 28, pika 1, të Ligjit Nr. 107, datë 31.07.2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, i ndryshuar; Ligjit Nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar; Ligjit Nr. 115/2014, datë 31.7.2014 “Për ndarjen administrativo-territoriale të njërive të qeverisjes vendore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar; Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 408, datë 13.05.2015 “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit”, i ndryshuar; Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 519, datë 20.09.2017 “Për përcaktimin e përbërjes së Këshillit Kombëtar të Territorit”, i ndryshuar dhe Lejes Zhvillimore të miratuar me Vendimin e KKT-së Nr.20, datë 03.12.2020, për objektin: “Kompleks banimi, hotelerie dhe shërbimesh 1, 2, 16 dhe 17 kate, me 2 kate parkimi nëntokë, në rrugën “Teodor Keko”, me vendndodhje Bashkinë Tiranë”, bien dakord si më poshtë:

NENI 1
OBJEKTI

- 1.1 Objekti i kësaj marrëveshje është delegimi i kompetencave Bashkisë Tiranë për kryerjen e procedurave përkatëse ligjore, në përputhje me legjislacionin për planifikimin dhe zhvillimin e territorit, në lidhje me ndërtimin e objektit:

“Kompleks banimi, hotelerie dhe shërbimesh 1, 2, 16 dhe 17 kate, me 2 kate parkimi nëntokë, në rrugën “Teodor Keko”, me vendndodhje Bashkinë Tiranë”, me subjekte zhvilluese shoqëritë “XH & M” sh.p.k, “ALFAZED” sh.p.k dhe “ERJONI” sh.p.k, sipas Lejes Zhvillimore përkatëse, të miratuar me vendimin e KKT-së Nr.20, datë 03.12.2020.

NENI 2 KOHËZGJATJA

- 2.1 Kompetencat objekt i kësaj Marrëveshjeje do të ushtrohen nga Bashkia Tiranë, nga data e paraqitjes së aplikimit fillestar të subjektit zhvillues për Leje Ndërtimi, deri në datën e lëshimit të Çertifikatës së Përdorimit.

NENI 3 TË DREJTAT DHE DETYRIMET E PALËVE

- 3.1 Këshilli Kombëtar i Territorit ka të drejtat dhe detyrimet si më poshtë:
- i. Vënien në dispozicion të Bashkisë Tiranë të Lejes së Zhvillimit të miratuar me vendimin e KKT-së Nr.20, datë 03.12.2020, për objektin: “Kompleks banimi, hotelerie dhe shërbimesh 1, 2, 16 dhe 17 kate, me 2 kate parkimi nëntokë, në rrugën “Teodor Keko”, me vendndodhje Bashkinë Tiranë”, me subjekte zhvilluese shoqëritë “XH & M” sh.p.k, “ALFAZED” sh.p.k dhe “ERJONI” sh.p.k,
dhe
 - ii. Hartën e Planvendosjes së Strukturave dhe Dokumentin e Rregullores së Veçantë, që shoqërojnë këtë Vendim.
- 3.2 Bashkia Tiranë ka të drejtat dhe detyrimet si më poshtë:
- i. Kryerjen e të gjitha procedurave administrative/ligjore, sipas përcaktimeve të parashikuara në dispozitat e Ligjit Nr. 107, datë 31.07.2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, i ndryshuar dhe VKM-së Nr. 408, datë 13.05.2015 “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit”, i ndryshuar, për objektin: “Kompleks banimi, hotelerie dhe shërbimesh 1, 2, 16 dhe 17 kate, me 2 kate parkimi nëntokë, në rrugën “Teodor Keko”, me vendndodhje Bashkinë Tiranë”, me subjekte zhvilluese shoqëritë “XH & M” sh.p.k, “ALFAZED” sh.p.k dhe “ERJONI” sh.p.k.



- ii. Shqyrtimin, verifikimin dhe vlerësimin e dokumentacionit përkatës teknik; të dokumenteve që vërtetojnë të drejtat pasurore të pronës/ave që marrin pjesë në këtë zhvillim, përfshirë marrëveshjet nëpërmjet pronarëve dhe zhvilluesit ose/dhe palëve të treta, si dhe të çdo akti/dokumenti tjetër ligjor, në përputhje me kushtet dhe kriteret e përcaktuara në legjislacionin në fuqi.
- iii. Miratimin dhe lëshimin e akteve/dokumenteve të poshtëshënuara, për objektin: “Kompleks banimi, hotelerie dhe shërbimesh 1, 2, 16 dhe 17 kate, me 2 kate parkimi nëntokë, në rrugën “Teodor Keko”, me vendndodhje Bashkinë Tiranë”, me subjekte zhvilluese shoqëritë “XH & M” sh.p.k, “ALFAZED” sh.p.k dhe “ERJONI” sh.p.k, sipas Lejes Zhvillimore përkatëse, të miratuar me vendimin e KKT-së Nr.20, datë 03.12.2020:
- Leje Ndërtimi;
 - Certifikatë Përdorimi.

NENI 4

ZGJIDHJA E MOSMARRËVESHJEVE

- 4.1 Palët do t'i zgjidhin të gjitha mosmarrëveshjet që mund të lindin nga zbatimi i kësaj marrëveshjeje me mirëkuptim ndërmjet tyre.

NENI 5

GJUHA E MARRËVESHJES

- 5.1 Kjo marrëveshje hartohet në 4 (katër) kopje në gjuhën Shqipe me vlerë të njëjtë.

NENI 6

EFEKTET JURIDIKE DHE PUBLIKIMI

- 6.1 Palët bien dakord se efektet juridike të kësaj Marrëveshjeje do të fillojnë në momentin e nënshkrimit të saj.
- 6.2 Kjo Marrëveshje publikohet në Fletoren Zyrtare.

PALËT

KËSHILLI KOMBËTAR I TERRITORIT

Përfaqësuar nga
Z. EDI RAMA



BASHKIA TIRANË

Përfaqësuar nga
Z. ERION VELIAJ

